

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPULL
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë, buxhetit, auditit të brendshëm, zhvillimit strategjik.

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 03 datë 29.04.2026

Nr. 788 Prot

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 22 datë 30.04.2026, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për “Miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për emergjencat civile dhe shtesa buxhetore për vitin 2026”,

Analiza ligjore: Miratimi i përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për emergjencat civile dhe shtesa buxhetore, është mbështetur tek nenit 54, pika “dh”, të ligjit 139/2015, “Për Vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.9936, dt.26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, nenit 65 të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, pikës 6, të nenit 15, të ligjit nr.87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, VKM nr.414, datë 08.07.2021, “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, i ndryshuar, pikës 19 të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave nr.2, datë 14.01.2026, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026”, Shkresës së Ministrisë së Mbrojtjes, AKMC, nr.429/6 prot., datë 15.04.2026, “Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për vitin 2026”, Shkresës së Ministrisë së Financave nr.4018 prot., datë 4.03.2026, “Shpërndarja e grantit të bazuar në performancë me burim financimin e huaj”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.67, datë 17.12.2025, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit të Bashkisë Dropull për vitin 2026”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.63, datë 27.11.2025, “Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.41, datë 29.08.2025, “Për konstatimin dhe vlerësimin e dëmeve për subjektet e evidentuara nga grupi i konstatimit, i ngritur pranë Bashkisë Dropull të shkaktuara nga zjarri masiv i datës 24.07.2025, në fshatin Kakavi, Njësia Administrative Dropull i Sipërm, në vlerë 17.187.287 lek”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.04, datë 30.01.2026, “Për miratimin e destinacionit të përdorimit të Grantit të Bazuar në Performancë të vitit 2025, me burim financimin e huaj”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr. 11, datë 27.02.2026, “Për miratimin e dëmshpërblimit të familjeve, që pësuan dëme nga zjarri në fshatrat Vrisera (Valendina Ruxho), Sotirë (Arian Niko) dhe nga shiu në Dervician (Lefter Baruta), me vlerë 10.583.151,4 lek me TVSH”, Shkresës së Bashkisë Dropull, dërguar AKMC-së, nr.91 prot. datë

15.01.2026, "Kërkesë për financim projekti,"Rehabilitimi i dëmeve nga përmbytjet, Nëntor 2025, në Bashkinë Dropull",

Situata aktuale e funksionit

Përdorimi i këtij fondi me miratim të Këshillit të Bashkisë, duhet të adresohet kryesisht në aktivitete dhe shërbime për të ndihmuar shtetasit, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme natyrore, të cilët janë evidentuar si të tillë me dokumentacionin përkatës dhe janë të patrajtuar, si edhe në shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese, mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet investimeve dhe blerjes së materialeve, shërbimeve dhe aktiviteteve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës publike dhe private të banorëve të komunitetit tonë.

Gjatë procesit të zbatimit dhe monitorimit të buxhetit të Bashkisë për vitin 2026, del e domosdoshme zbatimi i vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.63, datë 27.11.2025, "Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.41, datë 29.08.2025, " Për konstatimin dhe vlerësimin e dëmeve për subjektet e evidentuara nga grupi i konstatimit, i ngritur pranë Bashkisë Dropull, të shkaktuara nga zjarri masiv i datës 24.07.2025, në fshatin Kakavi, Njësia Administrative Dropull i Sipërm, në vlerë 17.187.287 lek", ku kryesore ishin, dëmi i shtëpisë së z. Hristo Karamano, ID, E90421010W, në fshatin Kakavi me vlerë 8.567.245 lek dhe dëmi i shtëpisë së z. Mihal Lako, ID, F90427022H, në fshatin Kakavi me vlerë 6.919.985 lek. Qytetarët e mësipërm janë dëmshpërblyer pjesërisht në muajin Janar 2026, nga fondi i ardhur nga AKMC në 30.12.2025, përkatësisht 4.258.988 lek dhe 3.484.626 lek.

Gjithashtu, Këshilli Bashkiak me vendimin nr. 11, datë 27.02.2026, "Për miratimin e dëmshpërblimit të familjeve, që pësuat dëme nga zjarri në fshatrat Vrisera (Valendina Ruxho), Sotirë (Arian Niko) dhe nga shiu në Dervician (Lefter Baruta), me vlerë 10.583.151,4 lek me TVSH".

Gjithashtu, Me anë të Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.04, datë 30.01.2026, "Për miratimin e destinacionit të përdorimit të Grantit të Bazuar në Performancë të vitit 2025, me burim financimin e huaj", është vendosur miratimi i përdorimit të Fondit (Grantit) të Bazuar në Performancë me burim Financimin e Huaj. Pikërisht ky Vendim duhet bërë pjesë e buxhetit të vitit 2026

Situata financiare :

Nga sa shihet më lart, fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile, është i pamjaftueshëm për të mbuluar plotësisht dëmet e shkaktuara nga rrënia e zjarrit masiv të datës 24.07.2025, në fshatin Kakavi, atij të datës 29.01.2026, në banesën e Andon Niko, Sotirë dhe Zjarrit të datës 02.02.2026, në abientet e biyenesit të Valendina Ruxho, Vrisera, prandaj duke vlerësuar kushtet social-ekonomike, si edhe duke ruajtur përparësinë, kërkojmë përfundimisht, miratimin Tuaj për përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile, si më poshtë:

1. Mbulim i shpenzimeve për dëmin nga zjarri i datës 24.07.2025, kasolle, depo, abiente private ndihmëse të znj. Elefteria Lako, ID, E6533101P, në fshatin Kakavi me vlerë 170.057 lek, në artikullin 604, sipas Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.63, datë 27.11.2025

2. Mbulim i **diferencës** së shpenzimeve për dëmin nga zjarri i datës 24.07.2025, të shtëpisë së z. Hristo Karamano, ID, E90421010W, në fshatin Kakavi me vlerë 1.117.000 lek, në artikullin 604, sipas Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.63, datë 27.11.2025.
3. Mbulim i një pjese të shpenzimeve për dëmin nga zjarri i datës 29.01.2026, të shtëpisë së z. Andon Niko, ID, E207170170, në fshatin Sotirë, me vlerë 3.400.560 lek, në artikullin 604, sipas Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr. 11, datë 27.02.2026.
4. Mbulim i një pjese të shpenzimeve për dëmin tek biznesi (hotel), me NIPT L02512601T, nga zjarri i datës 02.02.2026, të znj. Valendina Ruxho, ID, G25506019E, në fshatin Vrisera, me vlerë 1.006.572 lek, në artikullin 604, sipas Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr. 11, datë 27.02.2026.

Nëpërmjet Shkresës së Bashkisë Dropull, dërguar AKMC-së, me nr.91 prot. datë 15.01.2026, "Kërkesë për financim projekti,"Rehabilitimi i dëmeve nga përmytjet, Nëntor 2025, në Bashkinë Dropull", kemi përlllogaritur dëmet nga shirat e muajit Nëntor 2025, në vlerë 34.482.016 lek. Nga ana e këtij Institucioni, tashmë na janë dërguar vetëm 5.694.189 lek. Në këto kushte kërkojmë miratimin Tuaj, që këtë fond për investime ta drejtojmë, ku gjykohet, si më imediate dhe konkretisht për:

- Riparim i dëmeve në objektin "Mbrojtje nga Përroi i Selos, Dropull -Faza I" dhe në segmentet rrugorë Likomil-Selo-Klishar, në vlerë 5.694.189 lek.

II. Sipas Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.04, datë 30.01.2026, "Për miratimin e destinacionit të përdorimit të Grantit të Bazuar në Performancë të vitit 2025, është vendosur:

- a) Hartimin e Planit të Mbarështimit të Ekonomisë pyjore Dropull i Sipërm, Programi 04260, Artikulli 230, në vlerë 5.888.004 lek, (sipas përlllogaritjes së fondit limit me tarifatat sipas VKM nr. 12, datë 12.05.2010, për 1 ha, nga Drejtoria e Administrimit të Ujit, Pyjeve, Livadheve dhe Kullotave).
- b) Për blerjen e fidanëve pyjorë për gjelbërim në Njësitë Administrative Dropull i Poshtëm dhe Dropull i Sipërm, Programi 04260, Artikulli 602, në vlerë 667.446 lek (sipas preventivit të hartuar nga Drejtoria e Administrimit të Ujit, Pyjeve, Livadheve dhe

Këto fonde do duhet përkatësisht, të shtohet në ardhurat e Bashkisë nga Kapitulli 2, (grante të huaja) dhe në shpenzimet, sipas vendimmarrjes së mësipërme, në programin buxhetor 04260 (pyje-Kullota).

Të dy pikat e P.Vendimit plotësojnë objektivat tona në të dy programet buxhetore atë emergjencave civile, si dhe atë të Pyjeve-Kullotave të Bashkisë. Si të tilla, Ju ftojme për ti miratuar.

Drejtoria / sektori pergjegjes:

Drejtoria e Finances dhe buxhetit, pas vendimmarrjes se Grupit te Menaxhimit strategjik te Bashkise.

Monitorimi dhe raportimi :

Komisioni i Ekonomise, buxhetit, auditit te brendshem, zhvillimit strategjik., dhe keshilli bashkiak, monitorojne ecurine dhe realizimin e aktit, dhe mund te kerkojne raportim periodik per zbatimin e tij.

Impakti social / grupet që preken: Ky projekt vendim, impakton mbrojtjen civile, zhvillimin ekonomik, zhvillimin e fondit pyjor dhe ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit, nivelin e të ardhurave të veta, me efekt ne rritjen e mireqenies se qytetareve, nëpërmjet rritjes së investimeve dhe thithjes së fondeve nga projekte, ose programe evropiane për pyje, kullota dhe mjedisin.

A është objekt i konsultimit publik:

Ky akt i Keshillit te Bashkise, nuk eshte objekt i konsultimit publik, para se te miratohet nga Keshilli i Bashkise.

Komisioni i Përhershëm i “Ekonomise, buxhetit, auditit te brendshem, zhvillimit strategjik.” i mbledhur me datën 29 / 04 / 2026, shqyrtoi projekt vendimit nr. 22 datë 30/04 2026, relacionit e dokumentat shoqërues në me propozimin për, “Miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për emergjencat civile dhe shtesa buxhetore per vitin 2026”, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,


Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI:

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit
- c) refuzimin e miratimit të projektaktit
- d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:
 - Pika 1 (një) e projekt vendimit të ndryshoje në “-----“
 - Pika 4 (katër) e projekt vendimit të ndryshoje në “-----“
 - Tabela nr. 6 (gjashtë) e projekt vendimit të ndryshoje në “-----“
 - Paragrafi 15 (pesëmbëdhjetë) i projekt vendimit të ndryshoje në “-----“

Bashkëlidhur argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në proçesverbalin e mbledhjes së Komisionit.


(emri, mbiemri, firma)

Kryetar i Komisionit



Ejona Hano Sekretar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Datë ____ / ____ 2026